



Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

MLJENO:

08/12/2023

Nr.No.Br.

11/1754

## Drejtoria për Arsim dhe Edukim

Nr.Prot: 11/\_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 80 dhe nenit 81 të Ligjit për Zyrtaret Publik Nr.08/L-197, nenit 8 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, neni 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar nr. 04/L-32, neni 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës dhe të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017, UA 05/2021 Normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA 05/2015 Normativin për Mësimdhënsit e Arsimit Profesional, Drejtoria për Arsim dhe Edukim, shpallë:

### KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

| Nr. | Niveli, Shkolla                            | Pozita                             | Vendi i lirë/zëvendësim | Numri i pozitive | Orë |
|-----|--|------------------------------------|-------------------------|------------------|-----|
| 1   | SHFMU" Ismet Jashari-Kumanova" në Temeqinë | Mësimdhënës/e klasor               | Kohë të pacaktuar       | 1                | 20  |
| 2   | SHFMU" Ismet Jashari-Kumanova" në Temeqinë | Mësimdhënës/e klasor               | Kohë të caktuar         | 1                | 20  |
| 3   | SHFMU" Asim Vokshi" në Panorc              | Mësimdhënës/e i/e lëndës së TIK-ut | Kohë të pacaktuar       | 1                | 14  |
| 4   | SHFMU" Ganimete Tërbeshi" në Astrazup      | Punëtor tekniko shërbyes           | Kohë të pacaktuar       | 1                | 40  |

#### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, **duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;**
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (**nëse ka**).

#### II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (**Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138**) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të **MASHTI-it (UA Nr. 05/2021)** si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik..

### III. Kushtet dhe Kualifikimi:

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

### IV. Kushtet dhe Kualifikimi:

Për punëtor tekniko shërbyes shkolla fillore , shkolla e mesme

### V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur **30 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **11.12.2023** deri më datën **09.01.2024**.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e komunës, kati i parë,;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita (Vend i lirë/Zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Malishevës.

**Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.**

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në ueb- faqen e Komunës së Malishevës.

### Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

**Vërejtje:** Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Drejtorëshë e DKAE-së

Arbëreshë Krasniqi